

Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

2025/II

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

*MIRATUAR ME VENDIMIN NR.23, DATË 7.5.2025 TË
KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË*

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408

E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org



P Ë R M B A J T J A

PARATHËNIE	5
FJALA E GUVERNATORIT	7
1. INFLACIONI DHE QËNDRIMI I POLITIKËS MONETARE	9
2. MJEDISI I JASHTËM	12
2.1 Mjedisi ekonomik	12
2.2. Çmimet e mallrave në tregjet botërore	15
2.3 Normat e interesit	16
3. TREGJET FINANCIARE DHE KUSHTET E KREDITIMIT	18
3.1 Tregu financiar vendas	18
3.2. Kushtet e kreditimit	21
3.3. Kreditimi i sektorit privat	24
4. RRITJA EKONOMIKE	27
4.1. Produkti i brendshëm bruto	27
4.2. Kërkesa agregate	28
5. INFLACIONI, ÇMIMET DHE KOSTOT NË EKONOMI	36
5.1. Çmimet e konsumit	36
5.2. Përcaktuesit e inflacionit	39





PARATHËNIE¹

Objektivi kryesor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Stabiliteti i çmimeve nënkupton arritjen e normave të ulëta, por pozitive, të inflacionit dhe ruajtjen e tyre në këto nivele për një periudhë relativisht të gjatë. Në terma sasiorë, Banka e Shqipërisë e ka përkufizuar stabilitetin e çmimeve si një inflacion vjetor i çmimeve të konsumit në nivelin 3.0% në afatin e mesëm. Nëpërmjet ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, Banka e Shqipërisë ndihmon në krijimin e një ambienti monetar të qëndrueshëm dhe i vjen në ndihmë familjeve dhe bizneseve shqiptare për të planifikuar konsumin dhe investimet e veta.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mbledhet tetë herë në vit për të marrë vendime të politikës monetare, të cilat kanë për qëllim arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve. Këshilli Mbikëqyrës cakton normën bazë të interesit. Ndryshimet në normën bazë të interesit ndikojnë - me një kohë vonesë - normat e tjera të interesit në tregun financiar, si për shembull *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë dhe normat e interesit të kredisë. Në vijim, këto ndryshime sjellin rritjen apo uljen e kërkesës për mallra dhe shërbime nëpërmjet një zinxhiri që njihet me termin "mekanizmi i transmissionit". Ndryshimet në kërkesën për mallra dhe shërbime sjellin rritje apo ulje të çmimeve të tyre.

Mekanizmi i transmissionit përfshin edhe kanale të tjera nëpërmjet të cilave çmimet mund të ndryshojnë, si për shembull kanalin e kursit të këmbimit, atë të pritjeve inflacioniste dhe atë të pasurive financiare. Banka e Shqipërisë ka ndërtuar modele për të parashikuar ndryshimet në të gjitha elementet që ndikojnë çmimet dhe për të parashikuar inflacionin deri në tre vjet. Kur parashikimet tregojnë dominimin e presioneve të ulëta inflacioniste, të cilat mund ta çojnë inflacionin nën vlerën e shënjestruar prej 3.0%, ky është një sinjal që politika monetare duhet të jetë lehtësuese – normat e interesit duhet të qëndrojnë në nivele të ulëta. E kundërta është gjithashtu e vlefshme. Megjithatë, hartimi i politikës monetare nuk është një proces mekanik. Vendimmarrja e politikës monetare merr në konsideratë arsytet që shkaktojnë devijimin e inflacionit nga objektivi dhe kohën që i nevojitet ekonomisë të reagojë ndaj ndryshimeve në normat e interesit.

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës mbi politikën monetare merren në bazë të një shumëllojshmërie informacioni, përfshirë vlerësimet mbi zhvillimet ekonomike, parashikimet për inflacionin, ecurinë e tregjeve financiare, rreziqet dhe pasiguritë që rrethojnë parashikimet. Konsideratat dhe gjykimet mbi këto informacione gjenden në Raportin e Politikës Monetare, i cili është përbërësi

¹ *Kuadri i politikës monetare në Bankën e Shqipërisë përshkruhet në Dokumentin e Politikës Monetare, i disponueshëm në adresën https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Objektivi_dhe_strategjia/*



kryesor i vendimmarrjes për politikën monetare. Duke qenë se Banka e Shqipërisë synon të komunikojë me transparencë politikën monetare të saj, ajo e publikon rregullisht këtë raport dhe e vë në dispozicion të publikut.

Raporti i Politikës Monetare publikohet çdo tremujor. Ai përgatitet nga Departamenti i Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Raporti në vijim përmban të dhëna që datojnë deri në datën 30 prill 2025. Ai u shqyrtua dhe u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 7 maj 2025.



FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare e ka nisur vitin 2025 mbi baza të shëndosha dhe tregues pozitivë ekonomikë e financiarë.

Aktiviteti ekonomik ka vijuar të rritet, duke nxitur rritjen e punësimit dhe të pagave, ndërsa inflacioni ka qëndruar pranë nivelit 2%. Në të njëjtën kohë, kushtet e financimit për ekonominë kanë mbetur të favorshme dhe rritja e kreditimit ka përkrahur konsumin dhe investimet private. Në mars, agjencia "Standard&Poor's" rriti përsëri vlerësimin afatgjatë të kreditit sovran të Shqipërisë në "BB", me perspektivë të qëndrueshme.

Këto zhvillime pasqyrojnë një ambient makroekonomik të qëndrueshëm dhe një sistem bankar të fortë. Në veçanti, ulja e inflacionit nga nivelet e larta të periudhës post-pandemike ka përmirësuar fuqinë blerëse të qytetarëve shqiptarë dhe ka krijuar një mjedis më të qëndrueshëm për vendimmarrjen e bizneseve. Për më tepër, ky rezultat është arritur pa kosto për tregun e punës apo rritjen ekonomike, duke reflektuar qasjen e kujdesshme, proaktive dhe të balancuar të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Në përputhje me këtë filozofi dhe gjithmonë të përkushtuar ndaj stabilitetit të çmimeve, ne ndoqëm një qëndrim më akomodues të politikës monetare gjatë vitit 2024. Ulja e normës bazë të interesit në 2.75%, si dhe mbajtja e saj e pandryshuar në vijim ka dhënë një ndikim pozitiv në ekonomi. Ky qëndrim ka kontribuar në uljen e kostove të financimit për bizneset dhe familjet, në rritjen e kreditimit dhe në mbështetjen e aktivitetit ekonomik. Njëkohësisht, ai ka ndihmuar në menaxhimin e pritjeve për inflacionin, në prani të goditjeve nga jashtë, duke krijuar kushte të përshtatshme për kthimin e tij në objektiv.

Perspektiva për të ardhmen mbetet pozitive. Ekonomia shqiptare pritet të rritet afër potencialit të saj dhe inflacioni të stabilizohet pranë objektivit 3% brenda vitit 2026. Kjo rritje do të mbështetet nga bilancet e shëndetshme të sektorit privat, klima e qëndrueshme e besimit dhe vazhdimi i politikave makroekonomike të kujdesshme. Ndërkohë, rritja e punësimit dhe e pagave do të forcojnë më tej fuqinë blerëse të qytetarëve dhe do të përmirësojnë standardin e jetesës.

Megjithatë, pasiguritë në mjedisin e jashtëm janë shtuar. Intensifikimi i tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimet në politikat tregtare po zbehin perspektivën e ekonomisë botërore. Edhe pse ekonomia shqiptare ka një ekspozim të drejtpërdrejtë relativisht të ulët ndaj këtyre zhvillimeve, ndikime indirekte përmes ekonomisë evropiane mbeten të mundshme. Banka e Shqipërisë po ndjek me vëmendje të shtuar zhvillimet në tregjet ndërkombëtare, duke vlerësuar me kujdes çdo rrezik potencial që mund të reflektohet në ekonominë vendase.



Në mbledhjen e muajit maj, bazuar në parashikimet për ecurinë e ekonomisë dhe duke vlerësuar balancën aktuale të rreziqeve, vendosëm të mbajmë të pandryshuar qëndrimin e politikës monetare.

Vendimet tona të ardhshme do të vijojnë të jetë të kujdesshme dhe të fokusuara te ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si një nga shtyllat kryesore për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.



1. INFLACIONI DHE QËNDRIMI I POLITIKËS MONETARE

Informacioni i ri i analizuar në këtë raport tregon se ekonomia shqiptare ka vazhduar të rritet në tremujorin e parë të vitit 2025, e shoqëruar me përmirësimin e tregut të punës dhe stabilitetin e inflacionit. Mjedisi financiar ka vijuar të jetë i favorshëm, ndërsa kredia bankare ka financuar rritjen e konsumit dhe të investimeve të sektorit privat.

Ndonëse pasiguria në ambientin e jashtëm është rritur, perspektiva e ekonomisë vendase mbetet pozitive. Aktiviteti ekonomik projektohet në rritje gjatë viteve në vijim, ndërsa inflacioni parashikohet të kthehet në objektivin 3% brenda gjysmës së parë të vitit 2026.

[Bazuar në informacionin aktual dhe pritjet për të ardhmen, në mbledhjen e datës 7 maj 2025, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 2.75%. Ky vendim synon të ruajë premiset e duhura monetare për të garantuar kthimin e inflacionit në objektivin 3%.]

Pas një ecurie përgjithësisht pozitive gjatë vitit 2024, ekonomia globale u përball sërish me sfida të reja në këtë fillim viti. Vendosija e tarifave dhe paqartësitë lidhur me politikat tregtare në skenën globale kanë rritur ndjeshëm pasigurinë dhe kanë dobësuar perspektivën për rritjen ekonomike globale. Ekonomia evropiane është gjithashtu e ekspozuar ndaj këtyre zhvillimeve.

Rritja ekonomike në zonën euro ishte e ngadaltë gjatë vitit të shkuar, ndërsa inflacioni u rrit në 2.3% gjatë tremujorit të parë të vitit 2025. Rritja e inflacionit u ndikua kryesisht nga rritja e çmimit të gazit në muajin shkurt dhe të disa ushqimeve në muajin mars, ndërsa inflacioni i shërbimeve vijoi prirjen rënëse. Banka Qendrore Evropiane (BQE) pret një ulje graduale të inflacionit gjatë vitit aktual dhe luhatjen e tij pranë objektivit 2% nga tremujori i parë i vitit 2026. E motivuar nga vazhdimi i procesit dezinflacionist dhe nga dobësia e rritjes ekonomike, BQE-ja uli tre herë normën e depozitës njëditore, duke e zbritur në 2.25% në muajin prill. Për të ardhmen, ajo theksoi se vendimet do të merren mbi bazën e të dhënave të reja, veçanërisht në prani të nivelit të lartë të pasigurisë globale.

Trendet ekonomike në vend mbeten pozitive, të karakterizuara nga rritje e aktivitetit ekonomik, përmirësim i tregut të punës dhe qëndrueshmëri e inflacionit.

Në tremujorin e parë të vitit 2025, inflacioni mesatar rezultoi 2.0%, duke qëndruar i pandryshuar prej mesit të vitit të kaluar. Këto nivele të tij



pasqyrojnë më së shumti inflacionin e ulët të ushqimeve – kryesisht të atyre të papërpunuara – dhe kontributin negativ të çmimit të karburanteve. Ndërkohë, luhatjet e çmimeve të tjera kanë balancuar njëra – tjetrën, duke mbështetur stabilitetin e përgjithshëm të inflacionit. Prej muajit shkurt, rënia e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët ka dhënë një ndikim rënës në inflacion.

Në aspektin makroekonomik, inflacioni i ulët pasqyron presionet nga mjedisi i huaj, të cilat materializohen në vlera historikisht të ulëta të inflacionit të importuar. Nga ana tjetër, presionet nga ekonomia e brendshme mbeten të qëndrueshme, sikurse ilustrohet nga stabiliteti i treguesve të inflacionit bazë, të cilët luhaten rreth një mesatareje prej 2.0% që nga mesi i vitit 2024.

Qëndrueshmëria e presioneve të brendshme inflacioniste reflekton fazën pozitive të ciklik të biznesit, ku ndodhet ekonomia shqiptare. Aktiviteti ekonomik u rrit me 3.6% në tremujorin e katërt të vitit 2024, duke e çuar në 4% rritjen e të gjithë vitit. Rritja u nxit nga konsumi privat e publik, investimet dhe eksportet e turizmit, si dhe u përkrah nga bilanci dhe besimi i fortë i sektorit privat, nga kushtet e lehtësuara të financimit dhe rritja e kredisë. Në këndvështrimin sektorial, rritja u mbështet nga zgjerimi i aktivitetit në sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit, ndërsa aktiviteti në sektorin bujqësor dhe atë industrial vijoi të tkurret. Të dhënat e disponuara për tremujorin e parë të vitit 2025 ofrojnë sinjale pozitive për vazhdimësinë e rritjes ekonomike.

Tregu i punës u përmirësua më tej gjatë vitit 2024, me rritjen e qëndrueshme të punësimit dhe të pagave, ndërkohë që shkalla e papunësisë zbriti në nivele të ulëta historike. Të dhënat e Anketës së Forcës së Punës për tremujorin e katërt tregojnë një rritje të punësimit me 1.8%, si dhe një rënie të shkallës së papunësisë në 8.8%, nga 9.5% një vit më parë. Në të njëjtën kohë, pagat në sektorin privat u rritën me 9.5%, duke e çuar normën e rritjes për gjithë vitin në 8.6%. Në prani të një inflacioni të ulët e të qëndrueshëm, rritja e pagave është përkthyer në rritje reale të të ardhurave të familjeve dhe në përmirësimin e fuqisë së tyre blerëse.

Mjedisi financiar karakterizohet nga kushte të favorshme financimi, të cilat po mbështesin rritjen e konsumit dhe investimeve nëpërmjet rritjes së kredisë. Këto kushte pasqyrojnë normat e ulëta të interesit – në reflektim të politikës monetare lehtësuese dhe primeve të kontrolluara të rrezikut – si dhe një qasje më aktive të bankave ndaj kreditimit, të nxitur nga qëndrueshmëria e bilanceve financiare dhe klima pozitive e besimit. Gjithashtu, stabilizimi i kursit të këmbimit të Lekut ka ndikuar pozitivisht në kushtet e përgjithshme të financimit.

Në reflektim të këtij mjedisi financiar pozitiv, kredia për sektorin privat ka ardhur në rritje, duke regjistruar normën 16.7% në tremujorin e parë të vitit 2025. Në vijim të tendencave të një viti më parë, rritja e kredisë vijon të ketë një bazë të gjerë dhe diversifikim të lartë në përdorim, me një kontribut të madh nga kredia për investime, e cila ruan ritme dinamike. Paralelisht,



cilësia e portofolit të kredisë ka vijuar të përmirësohet, me raportin e kredive me probleme që ka rënë në 4.02%, duke reflektuar një menaxhim të mirë të rrezikut dhe performancë të qëndrueshme të huamarrësve.

Perspektiva e ekonomisë shqiptare mbetet pozitive. Aktiviteti ekonomik parashikohet të rritet pranë potencialit, i mbështetur nga kërkesa e brendshme dhe eksportet e turizmit. Fuqia blerëse e familjeve pritet të forcohet më tej, falë rritjes së pagave dhe punësimit. Në të njëjtën kohë, normat e ulëta të interesit, rritja e kredisë dhe klima e qëndrueshme e besimit pritet të nxisin rritjen e investimeve. Kërkesa e huaj për turizëm në Shqipëri pritet, po ashtu, të japë një kontribut pozitiv në rritje, ndonëse me një ritëm disi më të moderuar se vitet e kaluara.

Inflacioni parashikohet të rritet gradualisht dhe të stabilizohet pranë objektivit 3% gjatë gjysmës së parë të vitit 2026. Kjo ecuri pritet të reflektojë një rritje të inflacionit të importuar, ndërsa presionet nga ekonomia vendase pritet të reflektojnë një rritje të shëndetshme të aktivitetit ekonomik dhe pritje të ankoruara për inflacionin. Goditjet e përsëritura në çmimet e ushqimeve, të materializuara në nivelet e ulëta të inflacionit të tyre, si gjatë vitit 2024, ashtu dhe në fillim të këtij viti, kanë ngadalësuar kthimin e inflacionit në objektiv.

Pasiguria në mjedisin global është rritur. Ndryshimet në politikat tregtare dhe paparashikueshmëria e tyre kanë krijuar një mjedis ekonomik të paqëndrueshëm, me ndikime potenciale negative në rritjen globale, kushtet e financimit dhe luhatshmërinë e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i Shqipërisë ndaj ekonomisë amerikane është i kufizuar dhe i përqendruar kryesisht në disa degë specifike të ekonomisë. Megjithatë, ndikime të tërthorta përmes ekonomisë së Eurozonës mbeten të mundshme. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë po monitoron me kujdes situatën për të vlerësuar – nëse do të ketë – ndikimet potenciale në ekonominë vendase.

Në përputhje me analizën dhe parashikimet e paraqitura më lart, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 2.75%. Ky vendim reflekton gjithashtu balancën aktuale të rreziqeve dhe rritjen e pasigurisë për perspektivën e ekonomisë globale.

Vendimet e politikës monetare në të ardhmen do të orientohen nga të dhënat e reja. Kjo qasje siguron një përshtatshmëri të plotë me zhvillimet ekonomike dhe garanton fleksibilitetin e nevojshëm për të ndërhyrë në mënyrë efektive, në rast materializimi të skenarëve të rrezikut.



2. MJEDISI I JASHTËM


Aktiviteti ekonomik botëror është zgjeruar me ritme të ngadalta gjatë tremujorit të fundit të viti 2024, ndërsa treguesit e disponuar sugjerojnë një përmirësim të lehtë gjatë tremujorit të parë të vitit 2025. Parashikimet për rritjen e ekonomisë globale mbeten të ulëta dhe janë rishikuar për poshtë, kryesisht në reflektim të përshkallëzimit të tensioneve tregtare dhe të rritjes së pasigurisë për ecurinë e tyre në vijim.


Normat e inflacionit kanë mbetur përgjithësisht të qëndrueshme gjatë tremujori parë të vitit, ndërkohë që bankat qendrore të ekonomive të mëdha, në përgjithësi, kanë ulur normat bazë të interesit. Në vijim, bankat qendrore do të përballen me sfida komplekse, në prani të rreziqeve të dykrahshme ndaj inflacionit dhe perspektivës për rritje të ngadaltë ekonomike.

2.1 MJEDISI EKONOMIK

Pas një periudhe goditjesh të njëpasnjëshme, ekonomia globale shfaq shenja stabilizimi gjatë vitit 2024. Aktiviteti ekonomik u rrit dhe inflacioni u reduktua nga nivelet e larta të viteve të mëparshme. Megjithatë, rritja e ekonomive të zhvilluara mbeti në nivele të ulëta me rritjen ekonomike 0.9% në Eurozonë, 2.8% në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe 1.0% në Mbretërinë e Bashkuar (Grafiku 1, majtas). Treguesit paraprijës sinjalizojnë një përmirësim relativ të aktivitetit ekonomik gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 (Grafik 1, djathtas).

Ndërkohë, ritmi i rënies së inflacionit është ngadalësuar dhe, në disa ekonomi, inflacioni ka ardhur në rritje në tremujorin e parë të vitit 2025. Në Eurozonë, inflacioni u rrit në 2.3% në këtë periudhë nga 2.2% në tremujorin paraardhës, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar u rrit në 2.8%, nga 2.5%. Nga ana tjetër, inflacioni në SHBA qëndroi i pandryshuar në 2.7% në tremujorin e parë.





Bankat qendrore kanë vijuar të përshtatin me kujdes politikat e tyre monetare për të garantuar stabilitetin e çmimeve, në një kohë me rritje të ngadaltë ekonomike dhe pasiguri të lartë. BQE-ja dhe Banka e Anglisë kanë vijuar me lehtësimin e politikës monetare edhe gjatë tremujorit të parë, ndërsa Rezerva Federale e ndërpreu këtë cikël si pasojë e parashikimeve për një inflacion në rritje gjatë vitit.

Në këtë mjedis, ndryshimet në politikat tregtare dhe mungesa e qartësisë po rrisin pasigurinë ekonomike dhe po ushqejnë pritje për një ngadalësim të rritjes globale. Prej muajit shkurt, SHBA-ja ka shpallur dhe zbatuar disa raunde tarifash, ndërsa disa nga partnerët tregtarë kanë reaguar me masa të ngjashme. Situata kulmoi me 2 prill, kur SHBA-ja vendosi një tarifë bazë prej 10% për të gjitha importet, përfshirë edhe ato nga Shqipëria, si dhe tarifa shtesë për rreth 60 vende të tjera. Pas këtij vendimi, SHBA-ja dhe partnerët tregtarë ranë dakord për një periudhë 90-ditore negociatash, e cila vijon ende.

Sipas parashikimeve më të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar², aktiviteti ekonomik botëror parashikohet të zgjerohet me ritme më të ngadalta gjatë periudhës 2025-2026. Rritja e ekonomisë globale parashikohet të qëndrojë në 2.8% për vitin 2025 dhe 3.0% për vitin 2026, pas rritjes me 3.0% në vitin 2024. Këto parashikime janë më të ulëta se pritjet e kaluara dhe ngadalësimi është më i dukshëm në vendet e Amerikës Veriore dhe në Evropë. Në veçanti, ekonomia amerikane pritet të ndikohet mjaft negativisht nga vendosja e tarifave tregtare dhe ky ndikim do të përcillet në pjesën tjetër të botës, përfshirë ekonominë në zhvillim. Ndërkohë, inflacioni global parashikohet të bjerë në 4.3% në vitin 2025, dhe 3.7% në vitin 2026, nga 5.7% në vitin 2024.

² Referuar vlerësimeve të "World Economic Outlook – April 2025, IMF.




EKONOMIA E EUROZONËS

Ekonomia e Eurozonës u zgjerua me 1.2% në terma vjetorë në tremujorin e katërt të vitit 2024, një normë kjo lehtësisht më e ngadaltë krahasuar me tremujorin e mëparshëm (1.3%). Rritja u mbështet kryesisht nga konsumi privat, ndërsa investimet dhanë një kontribut negativ. Bizneset kanë shfaqur hezitim për kryerjen e investimeve, si pasojë e pasigurive të lidhura me tensionet gjeopolitike dhe mbi të gjitha me politikat e paqarta tarifore nga SHBA-të; një pasiguri që pritet të shtohet në vijim. Ndërkohë, tregu i punës ka mbetur i qëndrueshëm, me normën e papunësisë që ra në 6.1% në muajin shkurt.


Grafik 2.

Aktiviteti vlerësohet të jetë përmirësuar lehtësisht gjatë tremujorit të parë të vitit 2025...



Shënim: Indekse të vrojtimeve të biznesit që sinjalojnë për ecurinë e aktivitetit ekonomik në afat të shkurtër.
Burimi: Indekset PMI.

...ndërkohë që inflacioni paraqitet përgjithësisht i qëndrueshëm.



Burimi: Eurostat, institutet kombëtare të statistikave.

Inflacioni në Eurozonë u zgjerua lehtë në 2.3% gjatë tremujorit të parë të vitit, nga 2.2% një tremujor më parë. Të dhënat tregojnë se rritja e çmimeve të lëndëve energjetike – kryesisht gazit – në muajin shkurt, dhe e çmimeve të ushqimeve në muajin mars, janë kompensuar vetëm pjesërisht nga rënia e çmimeve të shërbimeve.

Në parashikimet më të fundit makroekonomike të BQE-së, inflacioni parashikohet të qëndrojë në 2.3% dhe 1.9% përkatësisht në vitet 2025 dhe 2026, ndërsa rritja ekonomike të përmirësohet në 0.9% dhe 1.2% për të njëjtën periudhë³. Në krahasim me parashikimet e kaluara, rritja ekonomike është rishikuar për poshtë.

EKONOMITË E RAJONIT⁴

Ekonomitë e rajonit janë shfaqur në përgjithësi të qëndrueshme gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024 (Tabelë 1). Ekonomia e Kosovës u rrit me 4.1%, e mbështetur nga rritja e fortë e konsumit privat, e investimeve dhe eksporteve. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rritja ekonomike u përshpejtua në

³ Burimi: Projektionet Makroekonomike të stafit të BQE, mars 2025.

⁴ Partnerët kryesorë tregtarë jashtë Bashkimit Evropian (Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia).



3.2%, nga 3.0% një tremujor më parë, e nxitur nga zgjerimi i investimeve dhe i konsumit publik, ndërkohë që konsumi privat përjetoi një rritje modeste dhe eksportet shfaqën një dinamikë negative. Në Serbi, rritja ekonomike rezultoi 3.3%, e pandryshuar nga një tremujor më parë, duke u mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit privat dhe e eksporteve, ndërkohë që investimet shënuan rritje mjaft të ngadaltë.

Ecuria e normave të inflacionit në rajon ka shfaqur një prirje rritëse gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 (Tabelë 1). Faktori i përbashkët pas rritjes së inflacionit në rajon ka qenë rritja e çmimeve të lëndëve energjetike në krahasim me tremujorin e kaluar. Ndërsa në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut ky zhvillim u pasqyrua në kontribute më pak negative të kësaj kategorie në inflacion, në Serbi inflacioni i çmimeve të lëndëve energjetike kaloi në territor pozitiv. Nga ana tjetër, inflacioni i ushqimeve të papërpunuara ka mbetur i ulët në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi, ndërsa është rritur në Kosovë. Midis vendeve të rajonit, Kosova regjistroi rritjen më të shpejtë të inflacionit, i cili u rrit me 1.3 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e kaluar.

Tabela 1. Treguesit ekonomike për vendet kryesore partnere tregtare

	Ndryshim vjetor i PBB (p.p)		Inflacioni vjetor (%)		Papunësia (%)	
	2024T3	2024T4	2024T4	2025T1	Publikimi i fundit	
Itali	0.9	0.8	1.3	1.8	5.9	
Greqi	2.6	2.5	3.1	3.0	8.6	
Kosovë	4.1	4.1	0.7	2.0	10.7	
Maqedoni e Veriut	3.0	3.2	4.1	4.2	11.9	
Serbi	3.3	3.3	4.4	4.5	8.6	
Shqipëri	4.2	3.6	2.0	2.0	8.8	

Burimi: Institutet statistikore përkatëse.

Parashikimet për vendet e rajonit për vitet 2025 dhe 2026 sugjerojnë: (i) një rritje ekonomike të qëndrueshme për Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë dhe ngadalësim të ritmit të rritjes në Kosovë; dhe (ii) një ngadalësim të inflacionit në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, dhe përshpejtim i tij në Kosovë.

2.2. ÇMIMET E MALLRAVE NË TREGJET BOTËRORE

Indeksi i çmimeve të lëndëve bazë⁵, shënoi një rritje të lehtë prej 0.7% gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, pas tkurrjeve në dy tremujorët e kaluar. Ky zhvillim ka vijuar të ndikohet nga prirja rritëse e çmimeve të metaleve për të katërtin tremujor radhazi, si edhe nga rritja e çmimeve të disa produkteve specifike (kakao, kafe etj.). Nga ana tjetër, çmimet e lëndëve energjetike dhe ushqimeve u shfaqën me rënie, e përqendruar kjo kryesisht në muajin mars të këtij viti (Grafik 3, majtas). Lulahshmëria afatshkurtër e çmimeve të lëndëve bazë


⁵ Indeks me frekuencë mujore i publikuar nga Banka Botërore, i cili përbëhet nga indeksi i çmimeve të lëndëve energjetike (qymyri, nafta buto dhe gazi natyral) dhe joenergjetike (produktet bujqësore, plehrat kimike dhe metalet).



në tregjet botërore ka pasqyruar pasiguritë e shtuara nga zbatimi i tarifave të reja tregtare ndërmjet SHBA-së dhe partnerëve të saj.


Çmimi i naftës Brent u kuotua rreth nivelit mesatar 75.6\$ për fuçi gjatë tremujorit të parë të vitit, duke shënuar një rënie vjetore prej rreth 9% (Grafik 3, djathtas). Faktori kryesor që po ndikon në rënien e këtij çmimi mbetet kërkesa globale e ulët, përballë një oferte mjaft më të lartë. Krahas këtij faktori, rënia e përshpejtuar e çmimit të naftës gjatë muajit mars u ndikua edhe nga vendimet e disa prej vendeve anëtare të OPEC-ut, lidhur me lehtësimin vullnetar të kufizimeve të prodhimit nga ana e tyre.

Indeksi i çmimeve të ushqimeve shënoi tkurrje vjetore prej 4% gjatë tremujorit të parë të këtij viti, rënie kjo me ngadaltë se në tremujorët e mëparshëm (Grafik 3, majtas). Dinamika negative vjetore e indeksit është ndikuar nga prodhimi i lartë, kushtet e favorshme të motit, si dhe rënia e vazhdueshme e çmimeve të naftës, ku këto të fundit kanë lehtësuar kostot në zinxhirët përkatës të prodhimit dhe të transportit.




2.3 NORMAT E INTERESIT

Pavarësisht lehtësimit të politikës monetare, kushtet e financimit në mjedisin e huaj mbeten ende të shtrënguara (Grafik 4, majtas). BQE-ja ka ndërmarrë tre ulje të normës së depozitës njëditore me nga 25 pikë bazë në muajt janar, mars dhe prill, duke e çuar atë në nivelin 2.25%. Banka e Anglisë uli normën bazë në muajin shkurt, por vendosi ta mbajë të pandryshuar në mbledhjen e muajit mars. Ndërkohë, Rezerva Federale zgjodhi të mbajë të pandryshuar normën e interesit në intervalin 4.25-4.5% gjatë tremujorit të parë të vitit, pas tre uljeve në vitin 2024.



Vendimet e bankave qendrore janë ndikuar si nga faktorë të brendshëm, ashtu edhe nga dinamika globale. Kështu, lehtësimi i mëtejshëm i qëndrimit të politikës monetare nga BQE-ja u mor për të përmirësuar kushtet e financimit dhe për të mbështetur rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, vendimi i Bankës së Anglisë për të mos ndryshuar normën bazë në muajin mars reflektoi qasjen e kujdesshme të saj, e cila balanconi progresin e procesit dezinfacionist, me rritjen e ngadalhtë ekonomike dhe të pasigurive. Në rastin e Rezervës Federale, qëndrimi pasqyroi pritjet për rritjen e inflacionit gjatë vitit, të nxitur nga efekti i tarifave të reja tregtare. Në përgjithësi, ecuria e interesave në tregjet ndërkombëtare financiare tregon një transmetim të ngadalhtë të qëndrimeve të politikës monetare në kushtet e financimit.

Tregjet financiare u karakterizuan nga një luhatshmëri e lartë gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, e nxitur nga pasiguritë në lidhje me politikat tregtare të SHBA-së. Njoftimet e njëpasnjëshme për vendosjen, shtyrjen dhe përshkallëzimin e tarifave tregtare kontribuuan ndjeshëm në lëvizjet e shpeshta dhe luhatjet e forta të këtyre tregjeve. Në këtë kontekst, *yield*-et e obligacioneve qeveritare të SHBA-së shënuan një rënie prej muajit janar, duke reflektuar shenjat e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik dhe një zhvendosje të investitorëve drejt aktiveve më të sigurta. Ndërkohë, në zonën euro, *yield*-et qeveritare fillimisht shënuan një rritje të përkohshme të ndikuar nga pritjet për ndikimin e planit fiskal gjerman për investimet infrastrukturore dhe të iniciativës së përbashkët për mbrojtjen evropiane. Por, në vijim, ato ranë, si pasojë e përshkallëzimit të tensioneve tregtare dhe efekteve frenuese të tyre të mundshme në rritjen ekonomike (Grafik 4, djathtas).




3. TREGJET FINANCIARE DHE KUSHTET E KREDITIMIT

Tregu i brendshëm financiar në këtë fillim viti ka vijuar të shfaqë prime rreziku në rënie dhe norma të ulëta interesi në të gjitha segmentet e tij. Tregu valutor është karakterizuar nga stabilitet i kursit të këmbimit të Lekut, rritje e vëllimeve të tregtimit dhe luhatshmëri e ulët.

Momenti pozitiv i ciklit të aktivitetit ekonomik dhe kushtet e favorshme financiare kanë mbështetur rritjen e qëndrueshme të kredisë për sektorin privat. Kjo rritje ka vijuar me bazë të gjerë, me kontribues kryesor financimin e bizneseve, të cilat këtë tremujor kanë rritur kërkesën për financimin e nevojave të tyre për likuiditet. Ndërkohë, ritmet e rritjes së depozitave kanë ardhur në përmirësim, duke reflektuar një ecuri më të mirë të depozitave të individëve dhe të bizneseve në Lek.

3.1 TREGU FINANCIAR VENDAS

Interesat e tregut ndërbankar në tremujorin e parë kanë rezultuar lehtësisht më poshtë se tremujori i mëparshëm. Diferenca e tyre nga norma bazë mbetet minimale, ndërkohë që tregu nuk ka shfaqur presione të shtuara për likuiditet (Grafik 5). Ecuria e interesave në tregun e parasë ka qenë në linjë me objektivin operacional të politikës monetare, duke mbështetur mekanizmin e transmisionit të saj. Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacione injektuese të likuiditetit në sistem me anë të instrumentit të saj kryesor, repos njëjavore. Shuma e injektuar në këta tre muajt të parë të vitit ka qenë më e ulët se në tremujorin e kaluar⁶, por kjo nuk ka ndikuar në ecurinë e primeve të likuiditetit në sistemin bankar.




⁶ Likuiditeti i injektuar në tremujorin e parë përmes repos 7-ditore rezulton rreth 26.2 mld lekë, duke shfaqur rënie nga niveli prej 51 mld lekësh të tremujorit të fundit të vitit të kaluar.



Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit janë moderuar në tremujorin e parë të vitit dhe Leku është shfaqur i qëndrueshëm. Kursi eur/lek rezultoi mesatarisht 98.9, nga 98.4 që ishte në tremujorin e fundit të vitit të kaluar (Grafik 6, majtas). Në terma vjetorë, mbiçmimi i Lekut u ngadalësua, duke zbritur në 4.7% në tremujorin e parë, nga 5.6% që ishte në tremujorin e mëparshëm. Qëndrueshmëria e kursit të këmbimit vijoi edhe gjatë muajit prill, ku kursi eur/lek rezultoi 99.1, pranë mesatares së vërejtur në muajin mars, ndërsa forcimi vjetor i Lekut u reduktua më tej, në 2.4%.


Grafik 6.

Leku është shfaqur i qëndrueshëm në tremujorin e parë...



Shënim: Të dhënat tregojnë ecurinë ditore të kursit të këmbimit të Lekut kundrejt Euros dhe Dollarit amerikan.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

...ndërsa presionet mbiçmuese afatgjata kanë ardhur duke u reduktuar.




Shënim: Të dhënat paraqesin treguesin e anshmërisë për mbiçmim/nënçmim.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Situata në tregun valutor ka qenë e qetë, e karakterizuar nga luhatshmëri e ulët e kursit dhe *spread*-e kuotimi brenda intervalit normal (Grafik 7, djathtas). Vëllimet e tregimit në tregun valutor, pavarësisht rënies sezonale krahasuar me tremujorin e katërt, kanë vijuar të rriten në tremujorin e parë, me rreth 12%. Shifrat e plota të bilanciit të pagesave për vitin 2024 konfirmuan vazhdimësinë e lidhjes së ngushtë mes ecurisë së vëllimeve në tregun valutor dhe ecurisë së tregtisë së mallrave dhe shërbimeve me jashtë, me një korrelacion prej mbi 90% (Grafik 7, majtas).


Grafik 7.

Vëllimet e tregimit në tregun valutor kanë vijuar rritjen vjetore dyshifrore



Shënim: Të dhënat paraqesin vëllimet tremujore të tregimit në tregun valutor dhe vlerën e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve (importe + eksporte), në mln euro.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Spread-et e kuotimit kanë rezultuar brenda intervalit normal të tyre




Shënim: Grafiku paraqet diferencën mes kuotimeve të çmimit të blerjes dhe të çmimit të shitjes të monedhës euro, mesatare mujore. Intervali është llogaritur si mesatare +/- një devijim standard.
Burimi: Banka e Shqipërisë.



Ecuria e Lekut kundrejt Dollarit amerikan është ndikuar më së shumti nga luhatjet në tregun ndërkombëtar të këtij të fundit. Leku u nënçmua ndaj Dollarit në dy muajt e parë të vitit, ku një dollar amerikan u kuotua mesatarisht me 95.1 lekë, nga 93.9 lekë në dhjetor të vitit të kaluar. Më pas, dobësimi i Dollarit amerikan në tregun ndërkombëtar, si pasojë e pasigurive mbi efektet e politikave tregtare të ndërmarra nga SHBA-të, diktoi rënien e kursit usd/lek në muajt mars dhe prill. Në muajin prill, kuotimi mesatar për dollarin ishte 88.4 lekë, nivel ky 6.6% më i ulët se ai i një viti më parë.


Yield-et e bonove dhe të obligacioneve në tregun primar vijuan të shfaqin ecuri rënëse edhe në tremujorin e parë të vitit. Ulja e yield-eve ka qenë e përgjithshme, por është shprehur disi më e fortë në segmentet e maturiteteve afatmesme dhe afatgjata (Grafik 8, majtas). Yield-i i bonos 12-mujore këtë tremujor shënoi mesatarisht 2.75%, nga 2.85% që ishte në tremujorin e mëparshëm. Ndërkohë, yield-et e obligacioneve shënuan një rënie prej mesatarisht 0.70 pikë përqindjeje nga vlerat e tremujorit të mëparshëm. Kurba e yield-eve ka pasqyruar këto zhvillime duke u ulur në nivel dhe zbutur pjerrësinë (Grafik 8, djathtas).



Përtej kahut lehtësues të politikës monetare, ecuria e yield-eve ka reflektuar nevojën më të ulët për fonde nga ana e qeverisë në këtë periudhë, përballë një kërkese të lartë nga ana e investitorëve⁷. Në këtë drejtim, evidentohet edhe rritja e interesit të investitorëve të huaj për të investuar në tituj borxhi të qeverisë shqiptare në monedhë vendase, nxitur edhe nga përmirësimi i fundit i vlerësimeve të agjencive ndërkombëtare për kreditin sovran të vendit.

Në vija të përgjithshme, kjo panoramë konfirmon prime të reduktuara rreziku, shprehur në reduktimin e diferencës së yield-it 12-mujor me normën bazë, si edhe të diferencave mes primeve të kërkuara për obligacionet afatgjata

⁷ Treguesi bid cover i kërkesës në ankanDET e tregut primar për tre muajt e parë rezultoi 1.9 nga 1.7 që ishte në tremujorin e fundit të 2024.



dhe atyre afatshkurtra. Kjo shprehet edhe në rezultatet e emetimit të parë të obligacioneve me maturitet 20-vjeçar, ku *yield*-i i realizuar në dy ankandet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe u ul në 6.15%, nga vlera fillestare prej 6.78%.

Në muajin shkurt u emetua me sukses edhe një eurobond me maturitet 10-vjeçar. Përmirësimi i vlerësimit ndërkombëtar për borxhin sovran u reflektua në një kërkesë veçanërisht të lartë për këtë instrument, çka rezultoi në një *yield* të ulët të tij, prej 5.0%.


3.2. KUSHTET E KREDITIMIT

Interesat e kredisë së re në Lek janë shfaqur relativisht të qëndrueshme dhe në nivele të ulëta në tre muajt e parë të vitit (Grafik 9, majtas). Ecuria e tyre tregon për përcjellje të mirë të dy uljeve të normës bazë, të ndërmarra në gjashtëmujorin e dytë të vitit të kaluar. Ndërkohë, primet e rrezikut të kredisë qëndrojnë në nivele të ulëta historike, sikurse dëshmohet nga diferencat e vogla mes normave të interesit të kredive dhe bonos 12-mujore. Në këndvështrimin makroekonomik, reduktimi i primeve të rrezikut në dy vitet e fundit është diktuar nga performanca e mirë e ekonomisë dhe aftësia për të përballuar goditjet negative, konsolidimi i bizneseve dhe rritja e aftësisë paguese të kredimarrësve.

Interesi i kredisë së re për **biznese** rezultoi mesatarisht 6.4% në tremujorin e parë të vitit, duke mbetur i pandryshuar nga tremujori i kaluar dhe lehtas më poshtë se mesatarja e vitit 2024, prej 6.6%. Për **individët**, normat janë ulur për kreditë konsumatore në 8.2%, nga 8.5% që shënonin në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Norma e interesit për kreditë hipotekare shënoi 3.7% këtë tremujor, duke mbetur e njëjtë me atë të tremujorit paraardhës.


Grafik 9.

Normat e interesit për kreditë në lekë janë shfaqur përgjithësisht të qëndrueshme në tremujorin e parë.



Shënim: Normat e interesit të kredisë së re në Lek si mesatare rrethqitëse 6-mujore. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesat për kreditë në euro janë në rënie prej gjysmës së dytë të vitit të kaluar.




Shënim: Normat e interesit të kredisë së re në Euro si mesatare rrethqitëse 6-mujore. Burimi: Banka e Shqipërisë.



Normat e interesit për kreditë në Euro kanë vijuar rënien në tremujorin e parë (Grafik 9, djathtas). Lehtësimi i shpejtë i politikës monetare nga BQE-ja është reflektuar në normat referencë të monedhës Euro në tregun ndërkombëtar, duke diktuar rënie të interesave të kredisë në Euro në vend pas muajit gusht të vitit të kaluar. Interesi mesatar i kredisë së re në Euro **për bizneset** shënoi 5.7% në tremujorin e parë, nga 6.1% që ishte në gjashtëmujorin e dytë të vitit të kaluar. Ndërkohë, interesi mesatar i kredisë hipotekare në Euro për **individët**, pas rënies së shpejtë në tremujorët e mëparshëm, regjistroi një ulje minimale prej 0.1 pikë përqindjeje këtë tremujor, duke u ndalur në 4.8%. Diferenca e interesave të kredisë midis Lekut dhe Euros prej muajit gusht të vitit të kaluar ka kaluar në territor pozitiv për bizneset, ndërkohë që mbetet negative, por në zvogëlim, për financimin e blerjes së banesave tek individët.


Grafik 10.

Normat e interesit për depozitat me afat kanë shënuar rënie për Lekun dhe mbetën të pandryshuara për Euron.




Shënim: Të dhënat tregojnë normat e interesit të depozitave të reja me afat në Lek dhe në Euro, në %.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Diferenciali i interesit lek/euro është ngushtuar për kreditë hipotekare, ndërsa mbetet i qëndrueshëm për depozitat.



Shënim: Të dhënat tregojnë diferencat mes normave të interesit në Lek dhe atyre në Euro, në pikë përqindjeje, për: kreditë e bizneseve, kreditë hipotekare dhe depozitat.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tremujori i parë është karakterizuar nga rënie e lehtë e interesave të depozitave në Lek, ndërkohë ato në Euro mbeten të pandryshuara, duke u luhatur në nivele minimale (Grafiku 10, majtas). Interesi mesatar i depozitave në Lek rezultoi 1.9%, nga 2.0% dhe 2.2% që ishte përkatësisht në dy tremujorët e fundit. Rënia e interesave të depozitave në këtë tremujor ka qenë si në maturitetet deri në një vit, ashtu dhe tek ato mbi një vit. Interesi mesatar për **depozitat në Euro** rezultoi në 1.2% këtë tremujor, duke qenë afërsisht i njëjtë me tremujorin paraardhës. Diferenca mes interesave të depozitave në Lek dhe atyre në Euro mbetet pozitive dhe e qëndrueshme.



HAPËSIRË INFORMUESE 1: KUSHTET E OFERTËS DHE KËRKESA PËR KREDI GJATË TREMUJORIT TË PARË 2025*


Bankat ndoqën përjasje të ngjashme me një tremujor më parë në kreditimin e sektorit privat, duke i mbajtur kushtet e ofertës të pandryshuara. Kërkesa për kredi u raportua e lartë, në reflektim të nevojave më të larta për financim nga të gjithë agjentët ekonomikë.

Standardet e kreditimit për kreditë akorduar bizneseve në tremujorin e parë nuk ndryshuan, duke qëndruar si të tilla për të tetin tremujor me radhë. Standarde të pandryshuara kreditimi u aplikuan në kreditë për biznesin e madh, në financimin e investimeve të planifikuara dhe në mbulimin e nevojave afatshkurtra për likuiditet. Kushtet e termat e kreditimit për kreditë e bizneseve në përgjithësi u mbajtën të pandryshuara. Për kreditë për bizneset e vogla e të mesme, bankat ndoqën një përjasje favorizuese, duke lehtësuar jo vetëm standardet, por edhe kushtet e termat e kreditimit. Kostot e kufizimet më të ulëta nga bilanci, së bashku me trysninë e shtuar nga konkurrenca në sistem bankar ishin nxitësit kryesorë pas politikave lehtësuese të kreditimit të ndjekura nga bankat. Shkalla e refuzimeve për kredi – në raport me totalin e aplikimeve për kredi – ndryshe nga një tremujor më parë, u raportua më e lartë, kryesisht në sajë të perceptimit të bankave mbi aftësinë paguese të kredimarrësve.

Kuadri kreditues mbeti i pandryshuar edhe për individët. Standardet, kushtet dhe termat e kreditimit mbetën të njëjtë, si në kreditë konsumatore ashtu edhe në kreditë për blerjen e banesave. Megjithatë, në kushtet e një konkurrence të lartë, bankat aplikuan marzhe më të ulëta në kreditë konsumatore.

Grafik 1 HI 1.

Kushtet e ofertës për kredi shfaqën ndryshime minimale nga një tremujor më parë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerat në grafik përfaqësojnë balanca neto. Vlerat pozitive për standardet e kushtet tregojnë lehtësim dhe anasjelltas. Vlerat pozitive për shkallën e refuzimeve tregojnë rritje të saj, dhe anasjelltas.


Kërkesa për kredi u raportua me rritje në çdo segment të biznesit sipas madhësisë dhe qëllimit të përdorimit të kredisë, për të katërtin vit me radhë. Ambienti me norma të ulëta të interesit në tregun vendas dhe atë të huaj, së bashku me përmirësimin e mëtejshëm të besimit të biznesit nxitën bizneset të kërkojnë sasi më të larta huash për financimin e investimeve dhe përballimin e nevojave afatshkurtra për likuiditete. Kërkesa për kredi e individëve, u raportua e lartë, për të tetin tremujor me radhë. Kërkesa e shtuar për kredi krahas nevojave më të larta për financimin e konsumit dhe të blerjes së banesave, u mbështet dhe



nga zhvillimet aktuale e të pritura në tregun e banesave, si edhe nga ambienti favorizues i normave të interesit.

Grafik 2 HI 1.

Kërkesa për kredi u raportua e lartë në të gjitha segmentet



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerat në grafik llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ato negative rënie të kërkesës.

* Analiza mbështetet në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues, i cili kryhet me frekuencë tremujore dhe publikohet në adresën https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/

3.3. KREDITIMI I SEKTORIT PRIVAT⁸

Kreditimi i ekonomisë nga bankat ka vijuar me ritme të larta edhe në tremujorin e parë të vitit 2025. Norma vjetore e rritjes së kredisë për sektorin privat, prej 16.7% në këtë tremujor, ishte rreth 1.0 pikë përqindje më e lartë se një tremujor më parë, duke reflektuar një fluks tremujor në nivele të larta historike, prej 30 miliardë lekësh. Kërkesa për kredi ka vijuar të jetë e lartë, si nga bizneset ashtu edhe individët, e nxitur nga rritja e vazhdueshme e ekonomisë, përmirësimi i besimit dhe i tregut të punës. Nga ana tjetër, treguesit pozitivë të shëndetit të sektorit bankar, dhe në veçanti përmirësimi i raportit të kredisë me probleme ndaj totalit, së bashku me konkurrencën e shtuar mes bankave, kanë përkrahur zgjerimin e ofertës për kredi. Së fundmi, mjedisi financiar ka vazhduar të karakterizohet nga norma të ulëta interesi dhe prime të kontrolluara rreziku. Si rezultat i këtyre faktorëve, portofolit i kredisë ndaj PBB-së shënoi një tjetër rritje në tremujorin e parë, në 32.2%, duke qëndruar rreth 2.2 pikë përqindje më lart se një vit më parë.

Analiza e kredisë sipas monedhave tregon një rritje më të ngadaltë të kredisë në Lek dhe përshejtim të asaj në valutë (Grafiku 11, majtas). Kështu,


⁸ Analiza e kredisë bazohet në setin e statistikave të flukseve sipas metodologjisë së BQE-së për flukset "reale" të kredisë, të pastruar si nga lëvizjet e kursit të këmbimit, ashtu edhe të kredive të nxjerra nga bilanci.



kreditimi në Lek u rrit me 15.2%, rreth 0.7 pikë përqindje më pak se rritja e shënuar një tremujor më parë. Ndërkaq, kredia në valutë përshpejtoi ritmet e rritjes në 18.7%, duke arritur nivelin më të lartë të pesë viteve të fundit. Ky zhvillim ka reflektuar kryesisht kreditimin e biznesit të madh dhe është ndikuar, ndër të tjera, edhe nga diferenca pozitive e normave të interesit midis Lekut dhe Euros për kreditë për biznese. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, portofoli i kredisë së bankave dominohet nga kreditimi në Lek, i cili përbën 57.2% të totalit.

Grafik 11.

Kredia për sektorin privat vijon të zgjerohet me ritme të larta, e mbështetur nga të gjitha kategoritë, por kontribut më të madh ka dhënë kredia për biznese.



Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimet vjetore (%) të kredisë të pastruar nga lëvizjet e kursit dhe nxjerrjet nga bilanci. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Kreditimi i bizneseve vijon të jetë kontribuuesi kryesor në rritjen dinamike të kredisë për sektorin privat (Grafiku 11, djathtas). Kredia për këtë segment u rrit me një normë të përshpejtuar prej 17% në tremujorin e parë. Kjo rritje reflektoi kryesisht zgjerimin e financimit për kapital qarkullues, i cili formoi rreth 80% të rritjes së kredisë së bizneseve këtë periudhë. Në krahasim me një vit më parë, rritja e kredisë për kapital qarkullues ishte 15% më e lartë. Ndërkohë, rritja vjetore e kredisë për qëllime investimi shënoi 18.3%, duke qëndruar në nivele të larta.

Nga ana tjetër, zgjerimi i kredisë për individët ka ruajtur një rritje të njëtrajtshme. Në tremujorin e parë, kredia për individë u rrit me rreth 16.2%, duke shënuar një ritëm të ngjashëm me një tremujor më parë. Kredia për banesa u rrit me një normë lehtësisht më të ngadaltë, prej rreth 17.5%, ndërsa kredia konsumatore përmirësoi ritmet e rritjes në 16.8% mesatarisht.

Zhvillimet pozitive në financimin e sektorit privat janë shoqëruar edhe me rritjen e fondeve të bankave, nëpërmjet rritjes së depozitave (Grafiku 12). Në tremujorin e parë të vitit, norma mesatare e rritjes së depozitave të bizneseve dhe individëve ka qëndruar e pandryshuar në rreth 8.6%, e njëjtë si në tremujorin e fundit të vitit. Më konkretisht, depozitat në Lek janë rritur me 8.8%, duke qëndruar 0.5 pikë përqindje më lart se në tremujorin paraardhës. Ky përmirësim vihet re si tek individët, ashtu dhe te bizneset, duke reflektuar kryesisht çlirimin e likuiditetit të akumuluar nga qeveria. Ndërkohë, depozitat në



valutë janë rritur më ngadalë, me një normë prej 8.4%, nga 8.9% një tremujor më parë, si pasojë e përdorimit të një pjese të likuiditetit të akumuluar nga bizneset.



Depozitat e individëve janë rritur me një ritëm më të shpejtë në tremujorin e parë të vitit, duke reflektuar rritjen e kursimeve në valutë dhe në Lek. Norma vjetore e rritjes së tyre arriti në 9.5%, nga 8.9% që ishte një tremujor më parë. Nga ana tjetër, rritja e **depozitave të bizneseve** është ngadalësuar në 5.5%, nga 6% në tremujorin paraardhës, si pasojë e tërheqjes së likuiditetit të akumuluar në valutë. Në raport me PBB-në, niveli i depozitave të bizneseve mbetet i lartë, në 12.5%.



4. RITJA EKONOMIKE

Ekonomia shqiptare shënoi një rritje vjetore prej 3.6% në tremujorin e katërt të vitit 2024, një normë kjo më e ngadalhtë krahasuar me tremujorët e mëparshëm. Rritja u mbështet nga kërkesa e brendshme, ndërsa kërkesa e huaj neto kontribuoi negativisht, kryesisht për shkak të rritjes së importeve.


Për gjithë vitin 2024, ekonomia u rrit me 4.0%, duke ruajtur një normë të ngjashme me vitin paraardhës, por me një strukturë të dominuar nga kërkesa e brendshme. Të dhënat e disponuara për tremujorin e parë të vitit 2025 japin sinjale pozitive për një rritje me bazë të gjerë të ekonomisë, përfshirë një rikthim të rritjes së eksporteve të mallrave në territor pozitiv.

4.1. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

Prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 3.6% gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, duke shënuar një ngadalësim krahasuar me një tremujor më parë (Grafik 13, djathtas). Rritja ekonomike u mbështet nga zgjerimi i aktiviteteve në sektorët e shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërsa aktiviteti i sektorit bujqësor dhe atij industrial u tkurr (Grafik 13, djathtas). Rënia e aktivitetit në sektorin e industrisë ishte me bazë të gjerë, duke përfshirë si industrinë nxjerrëse, ashtu edhe atë përpunuese.


Grafik 13.

Rritja ekonomike në tremujorin e katërt u ngadalësua në terma vjetorë dhe tremujorë.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
Shënim: Normat tremujore të korrektuara për sezonalitet.

Rritja ekonomike u mbështet nga shërbimet dhe ndërtimi.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Sektori prodhues kontribuoi negativisht me 1.0 pikë përqindje në rritjen ekonomike të tremujorit të katërt, si pasojë e tkurrjes vjetore të aktivitetit në sektorin e "Bujqësisë" me 2.7% dhe të "Industrisë" me 7.7%. Rënia në aktivitetin industrial rezultoi më e thellë në krahasim me tremujorin e kaluar, në



reflektim të përkeqësimit të aktivitetit në industrinë nxjerrëse dhe përpunuese. Nga ana tjetër, sektori i “Ndërtimit” vijoi të japë një kontribut pozitiv, ndonëse me intensitet më të ulët. Kontributi i tij ra në 0.2 pikë përqindje, nga 0.6 pikë përqindje në tremujorin e tretë, ndërsa norma vjetore e rritjes zbriti në 1.6%, nga 5.3% për të njëjtën periudhë.

Sektori i shërbimeve mbeti nxitësi kryesor i rritjes, me një kontribut prej 3 pikësh përqindjeje. Rritja e këtij sektori u mbështet nga të gjitha degët përbërëse të tij. Megjithatë, rritjen më të shpejtë dhe kontributin më të lartë e dhanë grupi i aktiviteteve “Tregti, transport, akomodim dhe shërbim ushqimor”, “Administratë publike, mbrojtje, arsim dhe shëndetësi”, si edhe “Pasuritë e paluajtshme”.

Ndërkohë, taksat neto kontribuuan ndjeshëm në rritjen ekonomike, me 1.6 pikë përqindje.


4.2. KËRKESA AGREGATE

Rritja ekonomike e tremujorit të katërt të vitit 2024 u nxit nga kërkesa e brendshme dhe kryesisht nga konsumi privat (Grafik 14, majtas). Rigjallërimi i konsumit privat, i cili u rrit me 3.3%, nga 0.7% në tremujorin e tretë, solli dhe përshejtimin e rritjes së kërkesës së brendshme në 2.6%, nga 2.2% për të njëjtën periudhë. Paralelisht me të, edhe investimet u rritën, por me norma të ngadalësuar krahasuar me tremujorin e tretë. Zgjerimi i investimeve u diktua nga ato private, ndërkohë që investimet publike u pakësuan.

Kërkesa e huaj neto kontribuoi negativisht në rritje, si pasojë e rritjes së impORTEVE dhe tkurrjes së eksporteve të mallrave (Grafiku 14, djathtas). Nga ana tjetër, eksportet e shërbimeve kanë vazhduar të zgjerohen me ritme të ngjashme me ato të tremujorit të tretë të vitit 2024.

Grafik 14.


Rritja ekonomike është mbështetur nga kërkesa e brendshme.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Shënime: Kontributet e komponentëve të kërkesës në rritjen ekonomike.

Kontributet nga kërkesa e huaj kanë qenë negative.




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Shënime: Kontributet e brendshme dhe të huaja në rritjen vjetore të kërkesës agregate.



Rritja e konsumit privat në tremujorin e katërt ishte shumë pranë rritjes mesatare të dy viteve të fundit, prej 3.3%. Zgjerimi i shpenzimeve konsumatore gjatë kësaj periudhe u nxit nga rritja e punësimit, e pagave, si dhe nga reduktimi i pasigurisë në mjedisin ekonomik (Grafik 15, majtas). Për më tepër, rritja e kredisë konsumatore dhe ajo e prurjeve nga remitancat vijuan të jenë burime të rëndësishme financimi. Rritja e konsumit u regjistrua në të gjitha kategoritë përbërëse, përfshirë mallrat ushqimore, mallrat e konsumit afatgjatë dhe shërbimet⁹.

Tregues indirektë të disponuar për tremujorin e parë të vitit 2025 sugjerojnë një vazhdimësi të dinamikës pozitive të konsumit privat (Grafik 15, djathtas). Treguesi i besimit konsumator është përmirësuar dhe qëndron mbi mesataren historike për të katërtin tremujor radhazi. Ndërkohë, konsumatorët raportojnë rritje të blerjeve të mëdha, ndërsa bizneset në sektorët e shërbimeve dhe të tregtisë raportojnë rritje të kërkesës konsumatore gjatë kësaj periudhe.



Rritja e investimeve totale u ngadalësua në tremujorin e katërt në 2%, nga 6.7% një tremujor më parë (Grafik 16). Rritja e investimeve u mbështet nga investimet private, ndërkohë që investimet publike kontribuuan negativisht¹⁰. Niveli i lartë i besimit të bizneseve, shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve, si dhe kërkesa konsumatore e rritur mbeten faktorët kryesorë që kanë nxitur ndërmarrjen e investimeve të reja, ndërsa kushtet e favorshme të financimit, rritja e kredisë bankare, krahas gjendjes së mirë financiare të biznesit, kanë mundësuar financimin e tyre. Tregues të tërthortë sugjerojnë se investimet e bizneseve janë përhshpejtuar në kategorinë e makinerive dhe pajisjeve, por ngadalësuar në aktivitetin ndërtues (Grafik 17, majtas).

⁹ Analiza për konsumin e shërbimeve mbështetet në treguesin e tërthortë të rritjes së vlerës së shtuar në sektorin e shërbimeve, sipas matjes së PBB-së sipas metodës së prodhimit. Analiza për konsumin e mallrave për konsum dhe afatgjata bazohet në të dhënat e indeksit të tregtisë me pakicë.

¹⁰ INSTAT nuk i publikon investimet të dezagreguara sipas llojit. Analiza lidhur me ecurinë e investimeve private dhe publike dhe sipas kategorive bazohet në vlerësime të brendshme gjykuar mbi tregues të tërthortë të disponuar.



Grafik 16.

Investimet totale u ngadalësuan në tremujorin e katërt 2024.




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Të dhëna indirekte sasiore dhe nga vrojtimet sugjerojnë se rritja e investimeve në tremujorin e parë 2025 do të vijojë me ritme të ngjashme. Treguesit indirektë sugjerojnë se kontributi kryesor në rritje do të vijë nga investimet publike (Grafik 17, djathtas), ndërsa faktorët mbështetës për rritjen e investimeve private mbeten të qëndrueshëm. Kështu, gjendja financiare e bizneseve dhe kredia për investime qëndrojnë në nivele të larta historike, ndërsa bizneset kanë vijuar të shfrytëzojnë maksimalisht kapacitetet e tyre. Po ashtu, bazuar në rezultatet e vrojtimeve të besimit, bizneset shprehen optimiste për rritjen e kërkesës konsumatore dhe rritjen e investimeve të reja gjatë këtij viti.

Grafik 17.


Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe gjendja financiare e bizneseve qëndrojnë mbi mesataren historike



Shënime: Gjendja financiare e bizneseve është mesatare balancash nga vrojtimet e besimit. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve është në përqindje të kapacitetit të plotë. Treguesit janë diferencë nga mesatarja afatgjatë.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Treguesit indirektë sugjerojnë rritjen e kontributit të investimeve publike në tremujorin e parë të vitit 2025



Shënime: Treguesit janë ndryshime vjetore në përqindje. Investimet publike janë vlerësim.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.


Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në terma realë dhanë një kontribut negativ në rritjen ekonomike të tremujorit të katërt. Deficiti tregtar u zgjerua me 33.4% në këtë periudhë, i ndikuar kryesisht nga zgjerimi i importeve, ndërkohë që edhe eksportet janë tkurrur krahasuar me një vit më parë (Grafik 18).



Në ngjashmëri me tremujorët e kaluar, eksportet totale shfaqën një ecuri të ndryshme midis eksporteve të shërbimeve dhe atyre të mallrave. Kështu, eksporti i shërbimeve, i nxitur nga turizmi, u rrit me 4.1% në tremujorin e katërt, ndërsa eksportet e mallrave u tkurrën me 21.3% për të njëjtën periudhë. Ndërkohë, importet e mallrave dhe shërbimeve u zgjeruan me 3.1%, normë kjo më e ngadaltë krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Ky ngadalësim erdhi si pasojë e rënies së importit të shërbimeve me 2.9%, ndërkohë që në tremujorin e tretë ishin zgjeruar me 1.1%. Nga ana tjetër, rritja e importeve totale u ndikua pozitivisht edhe nga rritja e importit të mallrave me 6.0%.

Grafik 18.

Eksportet neto dhanë një kontribut negativ në mijten ekonomike edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, me magnitudë të ngjashme me tremujorin e mëparshëm.



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Shënime: Kontributet e eksporteve dhe importeve në rritjen ekonomike.

Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2025 janë të disponueshme vetëm për tregtinë e mallrave dhe raportohen në vlerë nominale. Këto të dhëna tregojnë rritje të eksporteve dhe rënie të importeve në fillim të vitit, duke shfaqur një ecuri të ndryshme krahasuar me atë të vitit të kaluar. Në reflektim të këtyre zhvillimeve, deficitit tregtar i këtij tremujori është ngushtuar me 10.4%.


Eksportet e mallrave u zgjeruan me 4.7% gjatë tremujorit të parë, pas rënies me 18.9% në tremujorin paraardhës (Grafik 19, majtas). Rritja e eksporteve u nxit nga eksportet e kategorive “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Ushqime, pije dhe duhan”, të cilat shënuan një rritje të qenësishme të volumeve eksportuese të tyre. Nga ana tjetër, eksportet e kategorisë “Materiale ndërtimi dhe metale” u tkurrën, si pasojë e zhvillimeve strukturore specifike brenda industrisë, në një kohë që çmimet e metaleve në tregjet ndërkombëtare ishin me rritje.



Grafik 19.

Rritja e eksporteve reflekton rritjen e eksporteve të “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike”.

Lëvizjet e çmimeve të huaja kanë ndikuar në ecurinë e përgjithshme të importeve të mallrave.



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë

Shënim: Kontributet e kategorive kryesore në tregtinë e mallrave, në pikë përqindje.


Importet e mallrave ranë me 3.5% gjatë tremujorit të parë, pas një periudhe prej disa tremujorësh me norma rritjeje pozitive (Grafik 19, djathtas). Kategoritë kryesore që ndikuan në këtë ecuri ishin “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” dhe “Materiale ndërtimi dhe metale”. Për kategorinë e parë, rënia e importeve lidhet kryesisht me një efekt bazë nga rritja e fortë e tyre vitin e kaluar, ndërsa për kategorinë e dytë, vihet re një rënie e sasive të importuara. Nga ana tjetër, importet e kategorive “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Ushqime, pije dhe duhan” erdhën në rritje.

POLITIKA FISKALE DHE KËRKESA E SEKTORIT PUBLIK¹¹

Politika fiskale për vitin 2025 është projektuar të ketë natyrë konsoliduese, por në një intensitet më të ulët sesa në vitin e mëparshëm. Balanca primare edhe për këtë vit është projektuar të jetë pozitive, në 0.02% të PBB-së, nga 1.05% që rezultoi në vitin 2024.


Impulsi fiskal në fund të tremujorit të parë kaloi në terren pozitiv, i vlerësuar në 0.1 pikë përqindje të PBB-së (Grafiku 20, majtas). Rritja më e shpejtë e shpenzimeve krahasuar me të ardhurat gjeneroi vlera më të ulëta pozitive të bilancit fiskal krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Balanca buxhetore në tremujorin e parë shënoi një vlerë pozitive prej 33.8 miliardë lekësh. Suficiti fiskal u vlerësua në rreth 5.6% të PBB-së në tremujorin e parë, nga 5.7% i vlerësuar një vit më parë (Grafiku 20, djathtas).

¹¹ Të dhënat më të fundit të publikuara për sektorin publik deri në datën e përgatitjes së raportit i përkasin muajit nëntor. Tremujori i katërt i vitit 2024 është përafëruar me ecurinë e secilit prej treguesve gjatë muajve tetor e nëntor.



Grafik 20.


Impulsi fiskal kaloi në terren pozitiv.



Burimi: Ministria e Financave dhe Llogaritje DPM

Shënime: Ndryshimi i raportit të balancës primare për 12 muaj ndaj PBB-së, nga një vit më parë. Vlerat pozitive të këtij treguesi tregojnë që politika fiskale ka qenë lehtësuese, ndërsa ato negative politikë fiskale konsoliduese.

Suficiti fiskal ishte më i ulët se një vit më parë.




Burimi: Ministria e Financave

Shënime: Deficiti buxhetor ndaj PBB-së. Llogaritjet bazohen në flukse tremujore. Vlerat pozitive tregojnë deficit, e ato negative suficit buxhetor.

Shpenzimet në tremujorin e parë ishin rreth 147.4 miliardë lekë, me një rritje prej 11.7% në terma vjetorë (Grafiku 21). Rritja vjetore e shpenzimeve qëndroi mbi mesataren e shënuar në tremujorin e parë përgjatë katër viteve të fundit, me rreth 6.2 pikë përqindje. Zgjjerimi i shpenzimeve u mbështet në masën më të madhe të shpenzimet për sigurimet sociale, shpenzimet për personelin dhe ato për pushtetin lokal. Këto kategori kontribuuan përkatësisht me 4.3, 3.6 dhe 1.6 pikë përqindje në rritjen e totalit, duke formuar rreth 84% të saj, kryesisht në sajë të rritjes së vazhduar të pagave në sektorin publik. Investimet publike, ndryshe nga një vit më parë, ndikuan pozitivisht në rritjen e totalit të shpenzimeve, me një kontribut prej 1.5 pikësh përqindjeje.

Grafik 21.


Shpenzimet u rritën me ritme më të shpejta...



Burimi: Ministria e Financave

Shënime: Kompozimi i rritjes së shpenzimeve sipas tremujorëve.

...me kontribut pozitiv nga të gjithë komponentët



Burimi: Ministria e Financave


Shënime: Rritja vjetore, në %, e zërave kryesorë të shpenzimeve, sipas tremujorëve.

Të ardhurat buxhetore në tremujorin e parë ishin rreth 181.1 miliardë lekë, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.2% (Grafiku 22). Rritja e tyre ishte e ngjashme me atë të shënuar në tremujorin e fundit të vitit, por lehtë nën mesataren



e shënuar në tremujorin e parë përgjatë 4 viteve të fundit, me rreth 2.2 pikë përqindje. Rreth $\frac{1}{3}$ e rritjes u formua nga tatimi mbi të ardhurat personale, duke dhënë kështu sinjale pozitive për tregun e punës gjatë kësaj periudhe. Zërat e tjerë me kontribut të lartë në zgjerimin e totalit ishin të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe të ardhurat nga sigurimet sociale, me kontribute përkatësisht 2.9 dhe 2.8 pikë përqindje. Pjesa më e madhe e kontributit të TVSH-së, 74%, ishte nga aktiviteti i ekonomisë së brendshme, duke sugjeruar ecuri të kënaqshme të prodhimit të mallrave e shërbimeve në vend.

Grafik 22.



Huamarrja e re neto në tregun e brendshëm ra me 6.5 miliardë lekë në tre muajt e parë të vitit, në reflektim të strukturës së maturitetit që kishte portofoli i titujve dhe të strategjisë së huamarrjes së qeverisë përgjatë kësaj periudhe (Grafiku 23). Kështu, huamarrja në obligacione u pakësua me 4.3 miliardë lekë, si pasojë e maturimeve të larta të titujve referencë 3- dhe 5-vjeçare. Huamarrja në bono thesari u pakësua me 2.2 miliardë lekë, në reflektim të Strategjisë së Menaxhimit të Borxhit Publik, e cila synon zgjatjen e maturitetit të borxhit të brendshëm. Struktura e huamarrjes në tremujorin e parë diktoi një ekspozim më të ulët të bankave në financimin e borxhit të qeverisë, si pasojë e sasisë së lartë të maturuar gjatë kësaj periudhe të obligacioneve referencë 3- dhe 5-vjeçare, ku bankat zotërojnë pjesën më të madhe të tyre (mbi 90%). Jorzidentët vijuan të shtojnë portofolin e titujve qeveritarë, me rreth 5.3 miliardë lekë në tremujorin e parë të vitit.


Huamarrja neto në tregun e huaj për tre muajt e parë të vitit rezultoi rreth 58.7 miliardë lekë. Në muajin shkurt u emetua Eurobondi i shtatë në tregjet ndërkombëtare, në vlerën e 650 milionë eurove.

Zhvillimet në huamarrjen e brendshme e të huaj të qeverisë, së bashku me vlerat e suficitit fiskal të kësaj periudhe, u faktorizuan në teprica të larta likuiditeti, të cilat do të përdoren në vijimësi për shërbimin e borxhit të huaj dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të qeverisë.



Grafik 23.


Huamarrja në tregun e brendshëm ra...



Burimi: Ministria e Financave.

Shënime: Deficiti buxhetor sipas tremujorëve dhe mënyra e financimit të tij, në miliardë lekë.

...e së bashku me të dhe ekspozimi i tregut bankar ndaj borxhit të brendshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë.

Shënime: Huamarrja e qeverisë në tituj të borxhit, sipas blerësve, në miliardë lekë, sipas tremujorëve.



5. INFLACIONI, ÇMIMET DHE KOSTOT NË EKONOMI

Inflacioni u luhat rreth normës 2.0% gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, duke regjistruar një vlerë pothuajse të njëjtë me atë të tremujorit të katërt të vitit të kaluar. Presionet e brendshme inflacioniste mbeten përcaktuese dhe të qëndrueshme, sikurse ilustrohet nga stabiliteti i treguesve të inflacionit bazë. Ndërkohë, inflacioni i importuar ka vijuar të ruajë vlera të ulëta historike, si pasojë e vazhdimit të prirjes rënëse të çmimeve të naftës dhe të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare dhe mbiçmimit, ndonëse më të ngadaltë, të kursit të këmbimit.


Inflacioni parashikohet të rritet drejt objektivit 3% gjatë tremujorëve në vijim, i mbështetur nga qëndrueshmëria e presioneve të brendshme inflacioniste, ankorimi i pritjeve për inflacionin dhe rritja e inflacionit të importuar.

5.1. ÇMIMET E KONSUMIT

Inflacioni rezultoi i qëndrueshëm pranë vlerës 2% në tremujorin e parë të vitit 2025, duke reflektuar një ecuri të njëjtë me dy tremujorët paraardhës (Grafik 24, majtas). Inflacioni i ulët i ushqimeve të papërpunuara dhe kontributi negativ i çmimeve të karburanteve janë komponentët kryesorë që mbajtën inflacionin në këto nivele. Nga ana tjetër, luhatjet e çmimeve të komponentëve të tjerë kanë qenë të moderuara dhe kanë balancuar njëra – tjetrën. Muaji shkurt shënoi fillimin e aplikimit të çmimeve të reja të energjisë elektrike për konsumatorët. Efekti i drejtpërdrejtë në muajt shkurt-mars rezultoi në një reduktim të inflacionit total me 0.1 pikë përqindjeje.


Në terma makroekonomikë, presionet afatmesme me origjinë të brendshme u shfaqën të qëndrueshme, ndërkohë që presionet nga mjedisi i jashtëm mbetën të përmbajtura, sikurse pasqyrohen në vlerat e ulëta të inflacionit të importuar.

Inflacioni në vend është më i ulët se në Bashkimin Evropian dhe mesatarja e rajonit (Grafik 24, djathtas). Edhe pse ndjek një profil të ngjashëm me to, për shkak të faktorëve të përbashkët – si rritja e kontributit të çmimeve të lëndëve energjetike dhe të çmimeve të ushqimeve të përpunuara – gjatë tremujorit të parë, inflacioni në vend u ndikua edhe nga rënia e çmimit të rregulluar të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë.



Grafik 24.


Inflacioni mesatar u luhat në të njëjtat vlera të tremujorit të katërt, duke qëndruar pranë vlerës 2.0%.



Burimi: INSTAT, llogaritje të BSh-së.

Shënim: Norma e inflacionit është ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (publikuar nga INSTAT).

Inflacioni në vend është më i ulët se në ekonominë e Bashkimit Evropian dhe mesataren e rajonit



Burimi: INSTAT, llogaritje të BSh-së.

Shënim: Normat e inflacionit janë ndryshime vjetore, në përqindje.

Analiza e inflacionit sipas kategorive kryesore të shportës së konsumit tregon rënien e kontributit të grupit ushqimor në inflacionin e tremujorit të parë (Tabelë 2). Kontributi i kategorisë **“Ushqime të papërpunuara”** u zvogëlua mesatarisht me 0.2 pikë përqindje krahasuar me tremujorin paraardhës. Rënia ishte e theksuar në muajt janar dhe shkurt, kryesisht për nënkategorinë **“Perime”**. Nga ana tjetër, kategoria **“Ushqime të përpunuara”** shënoi kontribut në rritje, me 0.1 pikë përqindjeje, krahasuar me një tremujor më parë. Ky zgjerim i atribuohet kryesisht nënkategorisë **“Vajra dhe yndyra”**, kontributet e së cilës kaluan nga vlerat e ulëta negative në tremujorët e kaluar, në vlera lehtësisht pozitive në fillim të vitit 2025.

Kategoria **“Mallra konsumi joushqimor”** kontribuoi me një vlerë lehtësisht më të lartë krahasuar me fundin e vitit 2024, e ndikuar nga rritja e çmimeve të naftës dhe të gazit në tregjet e huaja gjatë muajve janar-shkurt të këtij viti. Megjithatë, kjo rritje u përcoll në tregun vendas me një intensitet më të ulët se sa në vendet e rajonit dhe në BE. Kontributi i çmimeve të naftës në inflacion vijon të jetë negativ.

Çmimet e komponentëve ku përfshihen shërbime, **strehim dhe mallra konsumi afatgjatë** dhanë një kontribut të njëjtë me një tremujor më parë, në formimin e inflacionit total.

Ndërkohë, inflacionin e ndikoi në krahun rënës kategoria e **mallrave me çmime të rregulluara**, për shkak të tarifimit të ri të çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët, duke filluar nga muaji shkurt. Si pasojë e këtij tarifimi, çmimi i energjisë elektrike shënoi një tkurrje me rreth 3%, duke kontribuar me -0.1 pikë përqindjeje në normën e përgjithshme të inflacionit.



Tabelë 2. Kontributet e kategorive kryesore në formimin e inflacionit vjetor, në pikë përqindje.


	T.2'23	T.3'23	T.4'23	T.1'24	T.2'24	T.3'24	T.4'24	T.1'25	Inflacioni vjetor T1'25 (%)
Ushqime të përpunuara	1.3	0.8	0.6	0.5	0.4	0.5	0.6	0.7	2.9
Bukë dhe drithëra	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	1.7
Qumësht, djathë dhe vezë	0.8	0.6	0.5	0.3	0.2	0.3	0.3	0.2	3.6
Ushqime të papërpunuara	2.5	2.3	2.1	0.9	0.3	0.4	0.7	0.5	3.0
Fruta	0.4	0.3	0.3	0.1	-0.2	-0.1	0.0	0.0	1.4
Perime	1.1	1.3	1.3	0.5	0.3	0.3	0.5	0.2	3.4
Mish	0.9	0.7	0.4	0.2	0.1	0.2	0.2	0.2	3.8
Shërbime	0.5	0.5	0.4	0.4	0.4	0.3	0.3	0.3	2.4
Mallra me çmime të rreg.	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0
Strehim (qira)	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.3	0.2	0.2	1.2
Mallra joushqimore	-0.6	-0.4	-0.1	0.1	0.3	0.1	-0.1	0.0	-0.5
Karburant	-0.9	-0.6	-0.2	-0.1	0.1	-0.2	-0.4	-0.2	-6.2
Mallra konsumi afatgjatë	0.5	0.4	0.4	0.3	0.3	0.3	0.2	0.3	3.8
Inflacioni (%)	4.6	4.1	3.9	2.7	2.1	2.0	2.0	2.0	2.0

Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e Bankës së Shqipërisë.

Shpërndarja e artikujve të shportës së IÇK-së sipas normës së inflacionit gjatë tremujorit të parë është e ngjashme me atë të tremujorit të mëparshëm¹². Pjesa më e madhe e artikujve – rreth 52.5% e shportës – përfshihet në kategorinë me inflacion nën 2% (Grafik 25, majtas). Kjo përqindje është lehtësisht më e ulët krahasuar me tremujorin e kaluar, kur kjo kategori zinte 55% të shportës. Ndërkohë, artikujt me inflacion 2% - 4% kanë shënuar një rritje të peshës në 32.9%, nga 29% një tremujor më parë. Nga ana tjetër, pesha e artikujve me inflacion mbi 4% shënoi vlerën 14.7%, duke rënë me 0.9 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e mëparshëm.


Grafik 25.

Shpërndarja e artikujve sipas kategorive të inflacionit ishte e ngjashme me tremujorin e mëparshëm.



Burimi: INSTAT, vlerësimet të BSH-së.


Frenimi i inflacionit u verifikua edhe në matjet e inflacioneve neto.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Qëndrueshmëria e inflacionit është verifikuar edhe në matjet e inflacionit neto, të cilat konfirmojnë praninë e presioneve të brendshme inflacioniste të qëndrueshme dhe relativisht të izoluara nga zhvillimet afatshkurtra (Grafik 25,

¹² Vlerësimi është bërë mbi bazën e të dhënave të inflacionit vjetor për një detajim në nivel 2-shifror sipas klasifikimit COICOP të artikujve të shportës së IÇK-së, detajim me një numër total prej 96 mallrash dhe shërbimesh.



djathtas). Në veçanti, inflacioni neto që përjashton ushqimet dhe energjinë¹³ mbeti pothuajse në të njëjtat nivele gjatë dy tremujorëve të fundit.

5.2. PËRCAKTUESIT E INFLACIONIT

Gjendja ciklike e ekonomisë vijoi të ishte pozitive gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024. Kështu, normat e shfrytëzimit të kapaciteteve vazhduan të qëndronin mbi mesataren afatgjatë, ndërsa të dhënat e tregut të punës treguan rritjen e punësimit, rënien e normës së papunësisë dhe rritjen e përshpejtuar të pagave.

Në linjë me performancën ciklike, presionet nga inflacioni bazë dhe i brendshëm mbetën mbizotëruese dhe të qëndrueshme në formimin e inflacionit total gjatë tremujorit të parë të vitit 2025. Ndërkohë, presionet nga inflacioni i importuar vijuan të jenë të ulëta.

Inflacioni bazë dhe ai i brendshëm mbetën të qëndrueshëm dhe mbizotërues në formimin e inflacionit total gjatë tremujorit të parë të vitit 2025.

Inflacioni bazë dhe ai bazë neto¹⁴ rezultuan përkatësisht 2.4% dhe 2.1% në tremujorin e parë, duke shënuar vlera thuajse të njëjta me ato të tremujorit paraardhës. Brenda tremujorit, këto matje u zgjeruan me rreth 0.2 pikë përqindje në muajin mars, kundrejt normave thuajse të pandryshuara të dy muajve të parë. Ky përshpejtim pasqyroi kryesisht rritjen e inflacioneve të nëngrupeve të qirave dhe të argëtimit. Matjet kryesore të inflacionit bazë vijuan të qëndrojnë mbi vlerat e inflacionit total, ndërkohë që përbërësit afatshkurtër mbetën jo vetëm nën inflacionin total, por edhe në nivelet më të ulëta historike. **Inflacioni jobazë** rezultoi mesatarisht 1.1%, në rënie krahasuar me tremujorin paraardhës. Ngadalësimi i tij u përcaktua nga rënia e inflacionit të ushqimeve të papërpunuara në muajin janar dhe e çmimit të energjisë elektrike në muajt shkurt dhe mars (Grafik 26, majtas).

Inflacioni i brendshëm rezultoi rreth 1.8% në tremujorin e parë, vlerë kjo e njëjtë me atë të tremujorit të kaluar. Inflacioni i brendshëm qëndroi më poshtë se sa inflacioni total dhe ai bazë, zhvillim që u theksua në muajin shkurt, për shkak të fillimit të efektit reduktues të vendimit për uljen e çmimit të energjisë elektrike. **Inflacioni i importuar** shënoi vlerën mesatare 2.9%, me luhatje përgjatë muajve të tremujorit në analizë. Rënia e lehtë nga tremujori i mëparshëm (3.1%) u shkaktua nga vlera e muajit mars (2.1%), e ndikuar nga çmimet në rënie të ushqimeve bazë, naftës dhe energjisë në tregjet e huaja, në prani të kursit ende të mbiçmuar të këmbimit. Për rrjedhim, vlerat dhe kontributet e inflacionit të importuar në atë total mbeten në nivelet e ulëta historike, kundrejt kontributeve përcaktuese nga inflacioni i brendshëm (74%) (Grafik 26, djathtas).


¹³ Këtu përfshihen kryesisht shërbime dhe mallra konsumi afatgjatë.

¹⁴ Nënshporta që mat inflacionin bazë është zgjeruar lehtësisht me rishikimin e peshave në vitin 2025, në 69.6% të totalit të shportës së IÇK-së, nga 69% në vitin 2024; inflacioni bazë neto përjashton edhe nëngrupet e disa ushqimeve të përpunuara, me inflacion të qëndrueshëm. Pësha e tij gjithashtu është zgjeruar në 46.5% me rishikimin e fundit, nga 46% një vit më parë.




Grafik 26.

Kontributi mesatar i inflacionit bazë u zgjerua lehtësisht në tremujorin e parë të vitit 2025.



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të BSH-së.

Inflacioni i brendshëm mbeti i qëndrueshëm dhe mbizotërues në formimin e inflacionit total.




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të BSH-së.

Në pasqyrim të persistencës më të fortë të inflacionit të shërbimeve dhe të mallrave me afat të gjatë përdorimi, inflacioni bazë zgjeroi lehtësisht kontributet në formimin e inflacionit total, në 83% në tremujorin e parë. Matjet e inflacionit bazë mbetën mbi mesataret e tyre të dekadës së fundit, ndërkohë që inflacioni i brendshëm preku mesataren përkatëse (Grafik 27).


Grafik 27.

Inflacionet bazë mbetën mbi mesataret historike respektive.



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të BSH-së.


Gjendja ciklike e ekonomisë u luhat në zonë pozitive edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024. Vlerësimet tona tregojnë një hendek prodhimi pozitiv, por në ngushtim, në reflektim të rritjes më të ngadaltë ekonomike në tremujorin e katërt. Nga ana tjetër, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve vazhdoi të qëndrojë mbi mesataren afatgjatë, ndërsa të dhënat e tregut të punës tregojnë për zgjerim të punësimit, normë papunësie në rënie dhe rritje të përshpejtuar të



pagave në sektorin privat. Zhvillimet e mësipërme ndikuan në qëndrueshmërinë e inflacionit bazë dhe të brendshëm, të cilët mbetën përcaktuesit kryesorë të presioneve të përgjithshme inflacioniste edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 (Grafik 28).

Grafik 28.

Pozicioni ciklik i ekonomisë paraqitet pozitiv edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Shënime: Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve, mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve është llogaritur si devijim i vlerës aktuale nga mesatarja historike, dhe më pas është zbatuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i shkallës së papunësisë vlerësohet si mesatare e hendeqeve të papunësisë sipas 3 metodave, të cilat vlerësojnë normën ekuilibër të papunësisë. Ai shprehet si diferencë e shkallës ekuilibër të papunësisë me atë faktike dhe më pas zbatohet metoda e mesatares lëvizëse.

Punësimi dhe papunësia¹⁵. Faza pozitive e ciklit të biznesit në ekonominë shqiptare pasqyrohet qartë në tregun e punës. Norma mesatare e papunësisë rezultoi rreth 8.5% gjatë vitit 2024, kundrejt 9.5% një vit më parë. Shkalla mesatare e punësimit dhe ajo e pjesëmarrjes në forcat e punës arritën respektivisht vlerat 68.6% dhe 75.7% gjatë vitit të kaluar, duke shënuar rritje të lehta krahasuar me një vit më parë (Grafik 29, majtas).


Të dhënat e disponuara për tremujorin e katërt të vitit 2024 tregojnë se punësimi është zgjeruar me 1.8%, me bazë të gjerë sektoriale. Për rrjedhim, norma e papunësisë zbriti në 8.8%, nga 9.5% një vit më parë. Ndërkohë, përmirësimi i tregut të punës u vërejt edhe në dimensione të tjera; norma e punësimit u rrit në 68.3%, me një zgjerim vjetor prej 1.5 pikësh përqindjeje, ndërsa shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës u ngjiti në nivelin 75.5%, nga 74.3% që ishte në tremujorin e katërt të vitit 2023.

¹⁵ INSTAT publikoi të dhënat e tregut të punës sipas Anketës Tremujore të Forcës së Punës për vitet 2023 dhe 2024 (12 mars 2025). Seritë e tregut të punës janë rishikuar për vitin 2023 në bazë të të dhënave të Censit 2023; ndërkohë janë raportuar për herë të parë edhe të dhënat për gjithë vitin 2024. Pritet të ndodhin rishikime të mëtejshme për periudhën para vitit 2023. Aktualisht, të dhënat janë të disponueshme me frekuencë tremujore për vitet 2023 dhe 2024, dhe vetëm për treguesit e shprehur në përqindje (jo në vlera absolute).




Grafik 29.

Norma e papunësisë është ulur krahasuar me një vit më parë dhe...



Burimi: INSTAT

...treguesit e punësisimit u zgjeruan në terma mesatarë gjatë vitit 2024.




Burimi: INSTAT.

Pagat, Kostot dhe Produktiviteti i Punës. Rritja vjetore nominale e pagave të sektorit privat u përshpejtua gjatë tremujorit të katërt, duke shënuar 9.5%, nga 5.4% një tremujor më parë (Grafik 30, majtas). Përshpejtimi i pagës vihet re kryesisht te sektorët me paga nën nivelin mesatar, si "Tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor" dhe "Ndërtimi". Rritja vjetore e pagës reale paraqitet gjithashtu e përshpejtuar në 7.5% në tremujorin e katërt, nga 3.4% një tremujor më parë.

Në reflektim të rritjes së pagës reale, kostot e punës për njësi l⁶ u zgjeruan me ritëm të përshpejtuar gjatë tremujorit të katërt. Ato u rritën me 8.0%, nga 1.1% në tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Në rritjen e kostos së punës për njësi, krahas ndikimit të rritjes së pagës, ka ndikuar edhe pakësimi i kontributit nga produktiviteti i punës, por në madhësi të vogël (Grafik 30, djathtas).


Grafik 30.

Rritja e pagës në sektorin privat u përshpejtua në tremujorin e katërt të vitit 2024.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.


Kostot e punës për njësi u zgjeruan në tremujorin e katërt të vitit 2024, kryesisht nga rritja e pagës reale.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Shënim: Kontributi pozitiv i produktivitetit të punës në llogaritjen e ndryshimeve vjetore të treguesit të kostos së punës për njësi, tregon se indeksi i produktivitetit të punës ka rezultuar me normat negative vjetore.

¹⁶ Treguesit e kostos së punës për njësi dhe e produktivitetit të punës janë vlerësime të Bankës së Shqipërisë. Ato i përkasin sektorit privat jobujqësor dhe llogariten duke u bazuar në të dhënat e INSTAT mbi statistikat tremujore të llogarive Kombëtare, të dhënave administrative të tregut të punës dhe të pagave.




Kostot e tjera prodhuese kanë vazhduar të rriten, por me ritme më të ngadalta gjatë tremujorit të katërt. Çmimet e prodhimit u rritën me 1.0%, nga 1.1% në tremujorin e mëparshëm, të ndikuara si nga rënia e çmimeve të prodhimit për tregun vendas (1.3% nga 1.6%), ashtu edhe nga ato për eksport (0.5% nga 0.6%). Indeksi i kushtimit në ndërtim, po ashtu shënoi një ngadalësim, duke zbritur në 1.2%, nga 1.6% në tremujorin e tretë.

Të dhënat për tremujorin e parë 2025 tregojnë se presionet e huaja inflacioniste kanë qëndruar thuajse të pandryshuara (Grafik 31). Treguesi i Presioneve të Huaja Inflacioniste (TPHI) u zgjerua me 4.1% gjatë këtij tremujori, po aq sa edhe në tremujorin e mëparshëm. Çmimet e huaja janë zgjeruar me ritme më të ngadalta, prej rreth 10.1%, në krahasim me 11.9% në tremujorin e katërt të vitit 2024, ndërkohë që mbiçmimi nominal efektiv është ngadalësuar në 6.0%, krahasuar me 7.8% një tremujor më parë. Presionet e moderuara inflacioniste nga jashtë kanë vijuar të transmetohen në vlerat dhe kontributet e ulëta historike të inflacionit të importuar, i cili formoi rreth 24% të inflacionit në tremujorin e parë të vitit.

Grafik 31.

Presionet e Huaja Inflacioniste nuk ndryshuan në tremujorin e parë të vitit 2025, krahasuar me ato të një tremujori më parë.



Burimi: INSTAT, Eurostat dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Pritjet për inflacionin të agjentëve të ekonomisë janë rishikuar për poshtë në tremujorin e parë 2025, bazuar në të dhënat e vrojtimeve¹⁷. Pritjet afatshkurtra (pas një viti) të bizneseve dhe të agjentëve financiarë shënojnë vlerat 3.3% dhe 2.4%, një rishikim për poshtë me përkatësisht 0.1 dhe 0.3 pikë përqindje kundrejt tremujorit të mëparshëm. Pritjet e konsumatorëve, megjithëse janë rishikuar për poshtë me 0.5 pikë përqindje, vijojnë të shënojnë vlera të larta edhe këtë tremujor (9.3%) (Grafik 32, majtas). Pritjet e agjentëve financiarë për inflacionin në horizontin kohor të dy dhe tre viteve mbetën shumë afër vlerës së dy tremujorëve të mëparshëm, prej rreth 2.7%, duke qëndruar më pranë objektivit afatmesëm për inflacionin (Grafik 32, djathtas).



¹⁷ Analiza e pritjeve për inflacionin bazohet në rezultatet e vrojtimit të besimit të konsumatorëve dhe në vrojtimin e pritjeve të agjentëve financiarë.



Grafik 32.

Pritjet për inflacionin pas një viti të bizneseve dhe të konsumatorëve u rishikuan lehtësisht për poshtë.

Pritjet afatmesme të agjentëve financiarë nuk ndryshuan dhe mbetën pranë objektivit për inflacionin.



*Shënime: Ndryshime vjetore në përqindje.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.*

